

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7975  
E enjte, 23 janar 2025  
Çmimi 0.50 €

Edukimi medial përballë  
medieve sociale,  
a po dëmtohet brezi i ri?



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ZGJEDHJET NË KOSOVË: KUSH VOTON E KUSH JO DHE PSE KA RËNDËSI?



Në të gjitha zgjedhjet, përveç zgjedhjeve lokale të vitit 2013, burrat në Kosovë kanë votuar në përqindje më të lartë sesa gratë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, ky

hendek është rritur në krahasim me zgjedhjet paraprake. Ndërkohë, janë të rinjtë ata që në ditën e zgjedhjeve drejtohen te vendvotimet në përqindjen

më të lartë. Mbi 53 për qind e të rinjve që për herë të parë kishin mundësinë e votimit, e shfrytëzuan atë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021

**DEPUTETËT  
E PACE-S:  
POLARIZIMI NË RITJE  
NË SKENËN POLITIKE  
MUND TA MINOJË  
DEMOKRACINË  
E KOSOVËS** F. 3



**AGJENCISË  
SË KOSOVËS PËR  
FORENZIKË I DHUROHET  
DONACION PËR  
EKSPERTIZA TË ADN-së  
PËR ZGJIDHJEN E  
RASTEVE TË PERSONAVE  
TË ZHDUKUR** F. 7

### OPINION

**AKUZAT NDAJ ÇLIRIMTARËVE  
TË KOSOVËS NË HAGË:  
KARAKTERI POLITIK DHE  
MUNGESA E BAZËS JURIDIKE**

F. 6

Shkruan: Prof. dr.  
Fejzulla BERISHA



### AKTUALE



**FSK-ja DHE EUCOM-i PAJTOHEN PËR  
THELLIM TË BASHKËPUNIMIT** F. 3

**VON DER LEYEN: BASHKËPUNIMI  
BE - SHBA, NË INTERES DYPALËSH**

F. 2

### EKONOMI



**RËNIE E PËRFITUESVE NGA SKEMAT  
E PENSIONEVE KRAHASUAR  
ME NJË VIT MË PARË** F. 8

**NGA 1 JANARI 'PASTRIMI' INKASON  
FATURAT E AMVISËRISË NË  
PRISHTINË** F. 8

### SPORT



**FADIL BYTYQI EMËROHET PRESIDENT  
I RI I FC SUHAREKA** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Çfarë po i ndalon shtetet anëtare të NATO-s të rrisin buxhetin për mbrojtje?

**BRUKSEL, 22 JANAR** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, pret që aleatët e Uashingtonit në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) të shpenzojnë më shumë para për bomba dhe plumba.

Propozimi i Trumpit për t'u kërkuar anëtarëve të dedikojnë pesë për qind të Prodhimit të Brendshëm Burto (PBB) për mbrojtjen u hodh poshtë nga shumë prej vendeve, por kërkesa për ndarjen e buxheteve më të mëdha nuk pritet të zhdukët.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë se shpenzimet mund të rriten deri në 3.7 për qind të PBB-së. Vetëm Polonia është mbi këtë nivel aktualisht.

Caku aktual i vendeve anëtare të NATO-s për buxhetin e mbrojtjes është 2 për qind të PBB-së, të cilin e arritën ose e kaluan shumica e anëtarëve në vitin 2024.

Caku i ri për shpenzimet ka të ngjarë të miratohet në një samit të NATO-s në Hagë në qershor. Për miratimin e këtij propozimi do të duhet pajtimi i 32 shteteve anëtare.

Vendet evropiane kanë rritur buxhetet e mbrojtjes që nga pushtimi në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022. Shumë liderë kanë thënë se buxhetet duhet të vazhdojnë të rriten edhe më tej për ta kundërshtuar kërcënimin e rritjes ushtarake nga Moska.

Por, implementimi i kësaj ideje është pjesa e vështirë.

Shumë qeveri tashmë përballen me vështirësi në financa publike, sisteme pensionesh të mbingarkuara dhe votues të pakënaqur me prioritetet e ndryshme të qeverive. Pasiguria politike e

rrit kompleksitetin e situatës. Një analizë e tri fuqive ushtarake më të mëdha evropiane thekson shkallën e pengesave për investime të mëdha në forcat e tyre të armatosura.

## Gjermania

Në terma nominalë, Gjermania është shpenzuesja më e madhe evropiane, duke shpenzuar pothuajse 98 miliardë dollarë në vitin 2024, sipas të dhënave të NATO-s.

Kjo shumë përkon me 2.12 për qind të PBB-së, më pak se shumë anëtarë të tjerë të NATO-s. Tentimet për ta rritur këtë përqindje janë kundërshtuar dhe kanë çuar në rënien e qeverisë gjermane në dhjetor.

Kundërshtimet në fjalë vijnë nga një rregull kushtetues i njohur si frenimi i borxhit. Ky rregull kufizon vlerën e borxhit të përgjithshëm të Gjermanisë dhe huamarrjen vjetore.

Për një propozim për ta pezulluar frenimin e borxhit për shkak të presioneve të jashtëzakonshme mbi buxhet - jo vetëm për mbrojtje - të shkaktuara nga lufta në Ukrainë, koalicioni qeverisës i Gjermanisë nuk arriti konsensus.

Ministria e Mbrojtjes publikoi planet për investime masive për ta bërë ushtrinë gjermane "gati për luftë," por ministri i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ishte i frustruar nga mungesa e fondeve.

Gjermanët tani do të shkojnë në zgjedhje parlamentare të parakohshme në shkurt, por mbrojtja është gati fare inekzistente si çështje fushate. Unioni Kristian-Demokrat duket se do të dalë fitues dhe



premtimi për t'i mbajtur shpenzimet "të paktën" 2 për qind të PBB-së nuk do t'i gëzojë zemrat në Uashington. Nicu Popescu nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie të Jashtme tha se situata e Gjermanisë ilustron një problem të gjerë në të gjithë Evropën. "Politikanët nuk kanë pasur një bisedë serioze me publikun e tyre për 30 vjet për nevojën për shpenzime në mbrojtje", tha ai. "Shumë kanë frikë ta bëjnë këtë bisedë. Ka një vështirësi politike që e pengon atë".

## Franca

Franca është një shembull i kësaj vështirësie. Pasiguria politike ka penguar planet për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes në afat të shkurtër. Presidenti Emmanuel Macron humbi shumicën parlamentare në zgjedhjet e parakohshme gjatë verës, duke e bërë të

pamundur deri tani miratimin e një buxheti për vitin 2025. Kjo ka bërë që buxheti për mbrojtje të mbetet në nivelet e vitit 2024 aktualisht, duke lënë rritjen e planifikuar prej 3 miliardë dollarësh të pasigurt.

Grupet kryesore në Parlament kanë prioritetet krejt të ndryshme për buxhetin. Si të majtët, ashtu edhe ekstremi i djathtë duan më shumë shpenzime sociale, ndërsa qendra e djathtë do ulje tatimesh. Dhe askush nuk duket i gatshëm të bëjë kompromis. Qeveria mund të humbasë një mocion besimi në çdo moment. "Mbrojtja kurrë nuk është në diskutim", tha Olivier Costa nga Sciences po në Paris. "E gjithë tema është rreth liderëve politikë që synojnë t'i fitojnë zgjedhjet e ardhshme presidenciale".

Ndërkohë, situata financiare e Francës është tashmë në një pikë delikate. Borxhi kombëtar ka arritur në 120 për qind të PBB-së, dyfishin e kufirit të

borxhit të Bashkimit Evropian. "Franca është më keq se Gjermania në të gjithë indikatorët ekonomikë", tha kryeministri Francois Bayrou më 14 janar.

Costa tha se "do të ishte shumë e vështirë në kontekstin aktual t'u shpjegohet qytetarëve se duhen më shumë shpenzime për mbrojtje".

## Britania e Madhe

Britania ka një nga buxhetet më të mëdha të mbrojtjes në Evropë. Me rreth 82 miliardë dollarë, ajo shpenzon 2.33 për qind të PBB-së për mbrojtje.

Skena politike e vendit është më e qëndrueshme, pasi qeveria e re ka një shumicë të madhe në Parlament. Por, kryeministri Keir Starmer fitoi zgjedhjet e vitit të kaluar me premtimin se nuk do t'i rrisë taksat dhe do ta shkurtojë huamarrjen.

Ai, gjithashtu, premtoi t'i mbajë shpenzimet në nivelet e mëhershme. Kjo përfshin buxhetin për mbrojtjen, gjithashtu edhe shëndetësinë, arsimin dhe infrastrukturën e transportit.

Borxhi kombëtar i Britanisë është aktualisht në nivelin më të lartë që nga vitet 1960. Kjo do të thotë se ka një mundësi shumë të kufizuar për ta rritur buxhetin për mbrojtje.

Në nëntor, Starmer i tha Ruttes se në pranverë qeveria do të "përcaktojë një rrugë" për t'i ngritur shpenzimet në 2.5 për qind të PBB-së.

Mungesa e një afati kohor për këtë angazhim është kritikuar, njëjtë si dhe ambicia e tij që është shumë më poshtë se shifra që ka përmendur Rutte. (Përgatiti: Doruntina Baftiu

/REL)

## Von der Leyen: Bashkëpunimi BE - ShBA, në interes dypalësh

**DAVOS, 22 JANAR** - Presidentja e Komisionit të BE-së, Ursula von der Leyen, e paralajmëroi presidentin e ri të ShBA-së, Donald Trump, që të mos nisë një luftë tregtare me Evropën duke sinjalizuar edhe gatishmërinë e saj për të negociuar. "Në botë nuk ka ekonomi të tjera që janë aq të ndërthurura sa tonat", tha ajo në Forumin Ekonomik Botëror në Davos.


Kompanitë evropiane punësojnë 3.5 milionë amerikanë në ShBA. Po ashtu, një milion vende të tjera amerikane pune varen

drejtpërdrejt nga tregtia me Evropën. "Vëllimi i tregtisë mes nesh arrin në 1.5 trilion euro, që korrespondon me 30 për qind të tregtisë botërore. Të dyja palët do të rrezikojnë shumë", tha von der Leyen.

Gjatë fushatës zgjedhore Trumpi njoftoi se synon të vendosë tarifa të reja prej 10 deri në 20 për qind për importet. Madje për mallrat kineze kjo tarifë do të shkojë deri në 60 për qind. Ai dëshiron ta përdorë këtë për të forcuar ShBA-në si një vend prodhimi dhe për ta ulur deficitin tregtar.

Trumpi ka halë në sy faktin

që kompanitë evropiane shesin dukshëm më shumë mallra në ShBA sesa kompanitë amerikane në BE. Edhe kancelari gjerman Olaf Scholz shprehu në Davos shpresën se ShBA-ja do të mbetet një nga aleatët më të afërt të Gjermanisë edhe në drejtimin e presidentit Trump. "Kjo është në interes të të dyja palëve", tha Scholz. Sidoqoftë, kancelari gjerman kërkoi maturi në qëndrimin ndaj ShBA-së. "Jo çdo konferencë shtypi në Uashington, jo çdo postim në 'Twitter' duhet ta zhysë Evropën në debate të nxehta



ekzistenciale", tha ai. "Bashkëpunimi i ngushtë midis Evropës dhe ShBA-së është i domosdoshëm për

paqen dhe sigurinë globale dhe motor për një zhvillim të suksesshëm ekonomik", shtoi Scholzi.



## Haradinaj takohet me Daniel Serwerin: Diskutuan për sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kandidat për kryeministër, Ramush Haradinaj, gjatë qëndrimit në Amerikë është takuar me profesorin Daniel Serwer. Haradinaj ka bërë me dije se me Serwerin ka biseduar për proceset dhe sfidat në të cilat po kalon Kosova. "Një bisedë e gjatë dhe

përmbajtësore me profesorin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme amerikane Daniel Serwer. Diskutuan për proceset dhe sfidat nëpër të cilat është duke kaluar Kosova. Angazhimi me dekada i prof. Serwer në Kosovë dhe Ballkan dhe memoria institucionale si ish-diplomat në Ballkan janë shumë me vlerë për rrugën dhe



përcaktimet e Kosovës dhe prioritetet që garantojnë paqen dhe sigurinë në Ballkan. E ftova z. Serwer që të vijë në Kosovë për t'i ndarë pikëpamjet dhe për ta ofruar ndihmën e tij, që Kosova të rikthehet në partneritetin strategjik me aleatë, posaçërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

## Deputetët e PACE-s: Polarizimi në rritje në skenën politike mund ta minojë demokracinë e Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 JANAR - Kosova ka bërë përgatitje të mira për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, por duhet ta adresojë "polarizimin në rritje" në skenën politike me veprime të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, sipas vlerësimit të një delegacioni nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE). I përbërë nga Petra Bayr dhe Andrea Eder-Gitschthaler nga Austria, dhe nga Mehmet Akalin nga Turqia, delegacioni i PACE-s përmbylli një vizitë parazgjedhore në Prishtinë, ku u takua me krerë shtetërorë dhe institucionalë, me përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe diplomatik, dhe me pjesëtarë të shoqërisë civile dhe të medieve. Sipas deputetëve të PACE-s, fushata zgjedhore në Kosovë

po zhvillohet në një mënyrë të qetë dhe paqësore, por shqetësues mbetet ndikimi i mundshëm i keqinformimit dhe përdorimi i inteligjencës artificiale gjenerative gjatë fushatës, në mes të mungesës së rregullimit të medieve online dhe transparencës për pronësinë e medieve. Delegacioni ka vlerësuar se "hezitimi i disa partive politike për të marrë pjesë në përballje në debate televizive, dhe bojkotimi i njoftuar i tri stacioneve të mëdha televizive nga partia në pushtet janë parë në dëm të informimit publik, veçanërisht të të moshuarve". Bayr, Eder-Gitschthaler dhe Akalin kanë theksuar "rolin vital të medieve në sigurimin e qasjes së votuesve në informata të llojllojshme dhe të sakta, që janë kyçe për të vendosur drejt". Më herët Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka thënë



se bojkotimi nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, i disa nga televizionet në Kosovë, shkon kundër transparencës dhe është përpjekje për ta "minuar rolin e gazetarëve dhe medieve" për ta mbajtur përgjegjëse "për politikën e saj". Delegacioni i PACE-s ka përmendur edhe shqetësimet e ngritura për "rritjen e retorikës populiste dhe nacionaliste, si

dhe përdorimin e gjuhës urrejtëse dhe përçarëse". Sipas tij, trendë të tillë "mund ta minojnë demokracinë dhe kohezionin ndëretnik, dhe mund të ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe në politikë". Deputetët e PACE-s kanë thënë se janë në dijeni edhe për trysninë dhe kërcënimin e raportuar të votuesve serbë të

Kosovës, si dhe për fushatat e dezinformimit nga mediet e mbështetura nga Beogradi, teksa kanë bërë thirrje për "shmangie të veprimeve që mund t'i shkallëzojnë tensionet". PACE, që përfaqëson parlamentarë nga 46 shtete evropiane, do të dërgojë një delegacion të gjerë prej 20 anëtarësh, të shoqëruar nga ekspertë ligjorë nga Komisioni i Venedikut, për ta vëzhguar procesin zgjedhor të 9 shkurtit. Në zgjedhjet parlamentare do të garojnë mbi 1 200 kandidatë, prej të cilëve do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit, dhe katër kandidatë për kryeministër: Albin Kurti i Vetëvendosjes, aktualisht në pushtet, Bedri Hamza i Partisë Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

## FSK-ja dhe EUCOM-i pajtohen për thellim të bashkëpunimit



PRISHTINË, 22 JANAR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka pritur të mërkurën në takim gjeneralmajor John Phillips, drejtor i Komunikimit dhe Kibernetikës në EUCOM. Fillimisht gjeneral Jashari e informoi gjeneralin Phillips mbi të arriturat e FSK-së në përgjithësi, në veçanti për të arriturat e FSK-së në fushën e komunikimit dhe mbrojtjes kibernetike. Pastaj takimi u fokusua në

reziqet e mundshme nga sulmet kibernetike dhe rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit në këtë sektor të rëndësishëm për zhvillimin dhe ngritjen e forcave të armatosura. Më pas gjeneralmajor Phillips theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me FSK-në në sigurinë e informacioneve dhe komunikimit. Phillips përgëzoi gjeneral Jasharin për arritjet e jashtëzakonshme që janë bërë në zhvillimin e FSK-së. Në fund të takimit të dy

gjeneralët u pajtuan që në të ardhmen të thellojnë bashkëpunimin në fushën e komunikimit përmes Marrëveshjes për Ndërveprimin dhe Sigurinë e Komunikimeve. Marrëdhëniet e FSK-së me aleatët e saj strategjikë janë të rëndësishme në fuqizimin dhe zhvillimin e saj e në linjë me këtë Komanda e Forcave Amerikane për Evropë (EUCOM) do të vazhdojë të luajë rol kyç në ngritjen e kapaciteteve të mbrojtjes.

## Osmani me deputetin e Bundestagut flasin për zhvillimin ekonomik dhe çështjet e sigurisë

PRISHTINË, 22 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim deputetin e Bundestagut, Volkmar Klein. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë,

me fokus në fuqizimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh, duke përfshirë zhvillimin ekonomik dhe çështjet e sigurisë. Presidentja Osmani shprehu mirënjohje për Klein, duke e falënderuar

për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës. Në takim u riafirmua rëndësia e partneritetit ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, si dhe vullneti i përbashkët për avancimin e prioritetëve të përbashkëta.







# Zgjedhjet në Kosovë: Kush voton e kush jo dhe pse ka rëndësi?

Në të gjitha zgjedhjet, përveç zgjedhjeve lokale të vitit 2013, burrat në Kosovë kanë votuar në përqindje më të lartë sesa gratë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, ky hendek është rritur në krahasim me zgjedhjet paraprake. Ndërkohë, janë të rinjtë ata që në ditën e zgjedhjeve drejtohen te vendvotimet në përqindjen më të lartë. Mbi 53 për qind e të rinjve që për herë të parë kishin mundësinë e votimit, e shfrytëzuan atë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021

**PRISHTINË, 22 JANAR** - Në nëntë palë zgjedhjet e mbajtura në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë më 2008, kanë votuar më pak se 50 për qind e gjithsej votuesve të regjistruar. Por, jo të gjitha grupet - komunitetet etnike, gjinitë e grupmoshat - janë paraqitur në vendvotime në të njëjtën përqindje. Të dhënat e ndara për gjini tregojnë se burrat votojnë në përqindje më të lartë se gratë. Në të gjitha zgjedhjet, përveç zgjedhjeve lokale të vitit 2013, burrat në Kosovë kanë votuar në përqindje më të lartë sesa gratë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare ky hendek është rritur në krahasim me zgjedhjet paraprake. Ndërkohë, janë të rinjtë ata që në ditën e zgjedhjeve drejtohen te vendvotimet në përqindjen më të lartë.

Mbi 53 për qind e të rinjve që për herë të parë kishin mundësinë e votimit, e shfrytëzuan atë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Asnjë grupmoshë tjetër nuk kishte përqindje më të lartë të votimit, ndërsa në vendin e dytë ishte grupmosha nga 41 në 44 vjeç, me gati 49 për qind. Të dhëna të ngjashme janë të qasshme edhe për votuesit e shumë prej vendeve të zhvilluara perëndimore. "Radio Evropa e Lirë" pyeti Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë nëse të dhëna të tilla do të mblidhen për zgjedhjet e ardhshme parlamentare që do të mbahen më 9 shkurt, por nuk mori përgjigje. Kelly Dittmar, nga Qendra amerikane për Gratë dhe Politikë, tregon se në ShBA këto të dhëna kanë qenë të qasshme

për publikun që nga viti 1980 dhe kanë luajtur rol tejet të rëndësishëm. "Në punën tonë shpesh flasim për vlerën e të dhënave në përcaktimin e një problemi. Dhe, pasi ta kesh përcaktuar problemin, mund të fillosh të kërkosh zgjidhje", thotë Dittmar për "Radion Evropa e Lirë".

Ajo tregon se në ShBA kjo gjë çuar në ndryshime konkrete, si rritja e presionit mbi partitë për të nominuar gra në pozita udhëheqëse dhe adresimi i politikave që pasqyrojnë përvojat e jetuara të grave. Përmes këtyre të dhënave, institucionet dhe shoqëria civile mund të analizojnë se komunitetet nënvotojnë dhe kështu mund të marrin iniciativa për të nxitur pjesëmarrje më të madhe politike të tyre, thotë Dittmar. Megjithatë, ajo thekson se shpesh ka arsye për mungesën e këtyre të dhënave. "Nëse të dhënat zbulojnë një hendek gjinor, por ka frikë se potenciali i grave vjen me një ideologji dhe parti specifike, atëherë mund t'i frikësohen definimit të problemit", thotë Dittmar. "Në anën tjetër, nëse gratë votojnë në shkallë të lartë, mund të ketë dëshirë të mos fuqizohet kjo gjë në shoqëritë ku burrat tentojnë

ta parandalojnë një lloj uniteti në mesin e grave", shton ajo. Për këto dy arsye, beson Dittmar, "absolutisht që mund të ketë njerëz në fuqi, veçanërisht burra, që nuk duan që këto të dhëna të bëhen të ditura".

Në Kosovë të dhënat e tilla nuk publikohen nga shumica e institucioneve publike. Ernera Dushica nga Instituti për Studime të Avancuara - GAP thotë se të dhënat e tilla nganjëherë nuk publikohen as kur ato grumbullohen.

Në dhjetor të vitit të kaluar ky institut publikoi një raport, ku tregohet se si institucionet publike në Kosovë nuk i përmbushin kriteret për publikim të të dhënave të ndara gjinore. "Mungesa e të dhënave të detajuara nuk është vetëm një problem teknik, por një pengesë strategjike për zhvillimin e politikave efektive. Kur nuk merren parasysh të dhënat, nuk mund të krijohen politika që i adresojnë nevojat e grupeve të ndryshme shoqërore", thotë Dushica për "Radion Evropa e Lirë".

E si mund të përdoren të dhënat konkretisht? Dushica merr një shembull: Të dhënat e regjistrimit të vitit të kaluar të popullsisë në Kosovë

tregojnë se në disa komuna, si në Kamenicë, mosha mesatare është më e lartë se mesatarja në gjithë vendin.

Sipas Dushicës, duke u bazuar në këto të dhëna, agjenda në këto komuna duhet të ndryshojë, duke u larguar nga politikat me fokus te të rinjtë. "Më mirë është që të sigurohet se shërbimet sociale janë më të qasshme për banorët e asaj zone. Nuk mund të jetë fokusi te politikat për të rinjtë, kur popullsinë e ke më të moshuar", thotë Dushica.

Dushica beson se bazimi i politikave në të dhëna të tilla do të ndihmonte në synimin që politikat t'i reflektojnë nevojat e të gjithë qytetarëve.

Për ta arritur këtë, ajo vlerëson se hapi i parë duhet të jetë publikimi i të dhënave që grumbullohen nga institucionet, por nuk ndahen. "Ne kemi hasur në një përgjigje që për këtë duhet resurse, por nuk është ashtu. Ne veçse kemi shumë të dhëna, por është kulturë institucionale që nuk e priorizon këtë aspekt", thotë ajo.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 në Kosovë ishin mbi 1.8 milion votues të regjistruar, por në fund vetëm 48.78 për qind e tyre votuan.



# Seftë në politikë, synojnë ta ndryshojnë ecjen e Kosovës

PRISHTINË, 22 JANAR - Nezir Kraki është gati ta lërë pas karrierën akademike në Francë për t'u angazhuar aktivisht në skenën politike të Kosovës.

Profesori i shkencës politike, që prej vitesh ligjëron në Universitetin Paris-Est Creteil, ka vendosur të garojë në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit - për herë të parë në një garë politike. "Për mua ligjet brenda të cilave funksionon një shoqëri duhet të jenë sa më të qarta dhe sa më të përputhshme me nevojat konkrete të qytetarëve", thotë 43-vjeçari për "Radion Evropa e Lirë".

Ai është në listën e kandidatëve të Lëvizjes Vetëvendosje, që aktualisht është në pushtet. Thotë se e ka zgjedhur atë për t'i çuar përpara ligjet në dobi të qytetarëve - pa i specifikuar cilat - por edhe politikën e jashtme të Kosovës.

Me synim ka vendosur të përfshihet për herë të parë në një garë zgjedhore edhe Drin Ejupi. Gazetar për 15 vjet në Kosovë, ai thotë se do të angazhohet për një shtyp më të lirë dhe jo vetëm. "... për një drejtësi më të pavarur, për qytetarë më të lidhur me sportin, sepse aty është edhe shëndeti, për zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik", thotë 35-vjeçari.

Për këto synime thotë se e ka gjetur veten te programi i Partisë Demokratike të Kosovës, në listën e së cilës është përfshirë tashmë si kandidat për deputet. Pjesë e Kuvendit për herë të

parë synon të bëhet edhe Jehona Lushaku Sadriu.

Prej vitesh profesore dhe shkencës politike në Universitetin e Prishtinës dhe drejtoreshë e Arsimit në komunën e Prishtinës, ajo i është bashkuar Lidhjes Demokratike të Kosovës në vitin 2021, ndërsa këtë vit ka vendosur të garojë për herë të parë për pozitën e deputetes.

Vendimin thotë se e ka marrë duke parë "kushtet e vështira në shkollë" dhe "cilësinë e dobët në arsimin parauniversitar". "Unë do ta shtyj përpara platformën e mësimi gjithëditor në të gjithë Kosovën", thotë 44-vjeçarja.

Për ta forcuar bindjen e saj, ajo kujton se një projekt i tillë ka nisur vitin e kaluar në pesë shkolla fillore në Prishtinë dhe thotë se rezultatet deri më tash janë pozitive.

Një kandidatë tjetër që ka nisur rrugëtim të ngjashëm, është edhe Emine Daci Zejnullahu. Në të 50-tat e saj, ajo është bërë për herë të parë kandidatë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe qëllimin thotë se e ka të qartë: ngritjen e sektorit të bujqësisë. Daci Zejnullahu është e shkolluar në fushën e ekonomisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe ligjëron në një kolegji privat në Prishtinë. Ajo shpreh bindjen se, duke qenë pjesë e vendimmarrjes, do të mund të angazhohet për rritje të prodhimit vendor. "Pjesa më e madhe e ushqimit në Kosovë është e importuar.



Remitencat dhe pagat tona shkojnë jashtë Kosovës dhe kështu ndërtohen shtetet e tjera", thotë Daci Zejnullahu. Të gjitha fushat ku synojnë t'i përqendrojnë energjitë këta kandidatë, në fakt, kanë nevojë për përmirësime. Për shkak të mosnormalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, Kosova ka ngecur në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Është vendi i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk e ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim në këtë bllok.

Gjendja e lirisë së medieve në vend, sipas Indeksit për Lirinë e Shtypit të

Reporterëve pa Kufij, është përqësuar vitin e kaluar. Në listën me 180 vende, Kosova është renditur në vendin e 75-të, apo 19 vende më poshtë se në vitin 2023. Cilësia e arsimit është, po ashtu, e ulët. Në tri teste të PISA-s - program ndërkombëtar për vlerësimin e nxënësve në lexim, shkencë e matematikë - që janë zhvilluar më 2015, 2018 dhe 2022, Kosova ka dalë gati në fund të listës botërore.

E sa i përket ekonomisë, vendi ka debalancë të madhe mes importit dhe eksportit tash e sa vjet. Mesatarisht në vit importon mallra në vlerë prej 5 miliardë eurosh,

ndërsa eksporton nën vlerën e 1 miliard eurove.

Premtime të ngjashme për ndryshime ka pasur edhe më herët, por mbetet për t'u parë se sa prej këtyre do të jetësohen kësaj radhe.

Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit do të garojnë mbi 1 200 kandidatë, prej të cilëve do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit, dhe katër kandidatë për kryeministër: Albin Kurti i Vetëvendosjes, aktualisht në pushtet, Bedri Hamza i Partisë Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

## Shqipëria dhe Ukraina nënshkruajnë marrëveshje në fushën e sigurisë

PRISHTINË, 22 JANAR - Shqipëria dhe Ukraina e kanë nënshkruar një marrëveshje afatgjatë në fushën e sigurisë në margjinat e Forumit Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës. Lajmi është dhënë nga kryeministri shqiptar Edi Rama dhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. "Në Davos, me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, nënshkruam një marrëveshje të rëndësishme në fushën e sigurisë", njoftoi Rama në "Facebook", pa dhënë më shumë hollësi.

Por, Zelensky tha se Ukraina dhe Shqipëria nënshkruan marrëveshje "afatgjatë për bashkëpunim dhe mbështetje mes dy vendeve tona". "Shqipëria i ka dhënë ndihmë ushtarake dhe humanitare Ukrainës prej se nisi pushtimi i plotë dhe do të vazhdojë ta mbështetë atë gjatë periudhës 10-vjeçare të marrëveshjes. Po ashtu, Shqipëria do të



kontribuojë edhe në koalicionin e avionëve luftarakë", tha Zelensky në X. Shqipëria, vend anëtar i NATO-s, e ka dënuar agresionin rus dhe ka vendosur sanksione kundër

Moskës për shkak të pushtimit të plotë të Ukrainës që nisi në shkurt 2022. Po ashtu, Tirana ka ofruar edhe ndihmë tjetër, përfshirë edhe strehimin e shtetasve ukrainas. Në fillim të vitit të

kaluar, Tirana ishte nikoqire e një samiti për Ukrainën, i bashkoi liderët e gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe ata të Moldavisë. Në këtë samit, që u mbajt me ftesë të

kryeministrit Rama, mori pjesë presidenti Zelensky.

Shqipëria dhe Ukraina kanë vendosur raporte diplomatike më 1993, dhe ato janë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Shqipëria veçse ka hapur kapitujt e parë të negociatave për anëtarësim.

Në fillim të këtij muaji Shqipëria e inauguroi objektin e Ambasadës së saj në Kiev të Ukrainës.

Kryediploti shqiptar, Igli Hasani, tha se ky objekt nuk do të ishte vetëm një urë bashkëpunimi mes shteteve, por edhe dëshmi për qëndrueshmërinë dhe angazhimin e përbashkët drejt një të ardhmeje në paqe dhe një Evrope "të bashkuar, të fortë dhe të begatë".

Ambasada, e hapur në fund të vitit 2024, pësoi dëme materiale disa javë më parë si pasojë e sulmeve me raketa ruse.



# Akuzat ndaj çlirimtarëve të Kosovës në Hagë: Karakteri politik dhe mungesa e bazës juridike



Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Akuzat ndaj çlirimtarëve të Kosovës në Hagë shpesh janë perceptuar si të motivuara politikisht, duke pasur si qëllim delegjimitimin e luftës për liri dhe barazimin e palëve në konfliktin e vitit 1998-1999. Këto akuza nuk kanë një bazë të fortë juridike, dhe më poshtë do të paraqiten disa argumente që mbështesin këtë pikëpamje:

1. Përdorimi selektiv i drejtësisë: Krimet e kryera nga forcat serbe janë dokumentuar gjerësisht, por shumë prej tyre ende nuk janë ndjekur penalisht. Ndërkohë, luftëtarët e UÇK-së përballen me akuza që shpesh bazohen në dëshmi të diskutueshme dhe të pabesueshme.
2. Lufta e drejtë për vetëmbrojtje: Konflikti i Kosovës ka qenë një luftë për çlirim nga represioni shtetëror dhe gjenocidi. Në kontekstin e të drejtës ndërkombëtare, rezistenca e armatosur kundër shtypjes nga një regjimi që kryen krime kundër njerëzimit është legjitime.
3. Prokuroria Speciale e Kosovës në Hagë: Krijimi i kësaj gjykate shihet nga shumë si një vendim i imponuar politikisht, që nuk pasqyron realitetin historik të konfliktit. Mungesa e balancës dhe e ndjekjes penale të krimeve të forcave serbe rrit perceptimin e padrejtësisë.
4. Dëshmitë e dyshimta: Shumë raste mbështeten në dëshmi që janë të kontestuara ose që vijnë nga burime me motive politike ose personale kundër çlirimtarëve.
5. Politizimi i proceseve gjyqësore: Gjykata Speciale perceptohet si një mekanizëm

për të ndikuar politikisht mbi Kosovën dhe për të dobësuar institucionet e saj, veçanërisht në momente kur vendi përpiqet të konsolidojë sovranitetin dhe pavarësinë. Përballja me këtë situatë kërkon një angazhim të fuqishëm të institucioneve të Kosovës për të mbrojtur historinë dhe drejtësinë, duke ndërtuar aleanca ndërkombëtare dhe kërkuar drejtësi të barabartë për të gjitha viktimat e luftës.

## Akuza ndaj çlirimtarëve të Kosovës në Hagë: Një çështje komplekse dhe politike

Akuza ndaj çlirimtarëve të Kosovës në Hagë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit është një çështje komplekse dhe shumë e debatuar, e cila ka elemente të thella politike dhe juridike. Disa aspekte kyçe e shpjegojnë karakterin politik të këtyre proceseve.

1. Krijimi i Gjykatës Speciale si

produkt politik: Gjykata Speciale për Kosovën u krijua pas presionit ndërkombëtar, kryesisht nga Bashkimi Evropian, pas raportit të Dick Marty-t në vitin 2010. Ky raport ngriti akuza të ashpra ndaj UÇK-së, përfshirë pretendimet për trafikim organesh, akuza që më vonë u kundërshtuan për mungesë provash konkrete. Krijimi i kësaj gjykate shpesh perceptohet si një kompromis politik për të kënaqur Serbinë dhe disa shtete skeptike ndaj Kosovës, në një periudhë kur dialogu Kosovë-Serbi ishte në qendër.

Rasti i "Shtëpisë së Verdhë": Akuzat për trafikim organesh janë refuzuar nga hetimet e EULEX-it dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY), që tregon se këto akuza janë përdorur për të njolltur luftën e UÇK-së.

2. Dëshmi të dyshimta dhe të politizuara: Përdorimi i dëshmitëve të dyshimta nga burime me motive politike është një nga problemet kryesore. Dëshmitarë të rëndësishëm, si në çështjen kundër Fatmir

Limajt, janë tërhequr nga dëshmitë ose janë zbuluar të kenë dhënë informacione të pavërteta.

Rasti i Hashim Thaçit dhe bashkëluftëtarëve: Akuza ndaj Hashim Thaçit dhe liderëve të tjerë të UÇK-së bazohen shpesh në dëshmi anonime ose burime serbe, që ngre dyshime mbi integritetin e procesit gjyqësor.

3. Selektiviteti i drejtësisë ndërkombëtare: Gjykata Speciale merret vetëm me krimet e UÇK-së, duke injoruar krimet masive të forcave serbe. Krime të dokumentuara si masakra e Reçakut dhe Mejës nuk janë ndjekur penalisht, duke krijuar një perceptim të padrejtësisë.

4. Politizimi i drejtësisë për të dobësuar Kosovën: Gjykata Speciale është perceptuar si një mjet për të dobësuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe për të goditur liderët politikë, siç ndodhi me arrestimin e Hashim Thaçit në një moment kyç të dialogut Kosovë-Serbi.

5. Lufta e drejtë e UÇK-së dhe mbështetja ndërkombëtare: Rezistenca e UÇK-së ka


mbështetje në të drejtën ndërkombëtare, me NATO-n që ka bombarduar Serbinë për të ndaluar krimet e regjimit të Millosheviqit, duke njohur luftën e Kosovës për çlirim.

6. Çfarë duhet bërë?: Kosova duhet të ndjekë një qasje më të koordinuar dhe aktive për të kundërshtuar padrejtësitë që burojnë nga këto procese: Dokumentimi i Krimeve Serbe: Duhet të thellohet puna për të dokumentuar dhe promovuar ndërkombëtarisht krimet e forcave serbe.

Angazhimi diplomatik: Institucionet e Kosovës duhet të intensifikojnë marrëdhëniet me aleatët ndërkombëtarë.

Kthimi i narrativës: Duhet ndërtuar një strategji komunikimi për të promovuar luftën e drejtë të Kosovës dhe për të kundërshtuar narrativat që e barazojnë agresorin me viktimën.

Proceset në Hagë janë vetëm një pjesë e betejës për drejtësi dhe të vërtetën historike. Kosova duhet të mbrojë luftën e saj të drejtë për liri dhe pavarësi pa u dorëzuar përballë këtyre sfidave.



## Aktakuzë kundër dy të pandehurve për përgatitje të veprës penale "Vrasje e rëndë"

PRISHTINË, 22 JANAR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pas zhvillimeve të hetimeve, ka ngritur të mërkurën aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, ndaj të pandehurve A. L. dhe B. B.

Sipas aktakuzës, për të pandehurit A. L. dhe B. B. ekziston dyshimi i bazuar

mirë se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale: "Përgatitje e veprës penale Vrasje e Rëndë", sipas nenit 173, par. 1, nënpar. 1.6, lidhur me nënpar. 1.13, lidhur me nenin 27, par. 2, lidhur me 1, në formë të bashkëpunimit marrëveshja për të kryer veprë penale nga neni 35, par. 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Po

sipas aktakuzës, për dy të pandehurit ekziston dyshimi i bazuar mirë, se kanë kryer edhe veprën penale: 'Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve', nga neni 366, par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Prokurori nga Prokuroria Speciale ka kërkuar nga Gjykata që të pandehurit t'i shpallë fajtor e t'i dënojë sipas ligjit".





## Edukimi medial përballë medieve sociale, a po dëmtohet brezi i ri?

PRISHTINË, 22 JANAR - Edukimi medial është bërë një çështje emergjente në arsim, sidomos kur flitet për përdorimin e medieve sociale nga fëmijët. Një hulumtim i realizuar nga profesorët e Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, Faton Ismajli dhe Arben Fetoshi, ka nxjerrë në pah problemet e të nxënësve të klasave të pesta. Sipas të dhënave, pothuajse 100 % e nxënësve të klasave të pesta kanë telefon dhe kalojnë mesatarisht tri orë në ditë në medie sociale, me një pjesë të konsiderueshme që nuk kanë asnjë kufizim në përdorimin e tyre. "Një pjesë e madhe e fëmijëve konsumojnë përmbajtje argëtuese, ndërsa një numër më i vogël shikon përmbajtje që mund të ndikojë në edukimin e tyre", theksoi Ismajli, duke shtuar se shumë fëmijë nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mënyrën e

përdorimit të sigurt të medieve sociale. Profesori Faton Ismajli tha se, sipas hulumtimit, "rreth 39.6 % e mësimitdhënësve kanë raportuar se nxënësist kanë vështirësi me përqendrimin, ndërsa 28.1 % janë shprehur se ka rënie në lexim si pasojë e përdorimit të pandërprerë të medieve sociale". Profesori Ismajli e konsideron edukimin medial si një komponent të domosdoshëm në arsim. "Edukimi medial është urgjencë që të bëhet lëndë obliguese në sistemin arsimor. Nxënësist duhet të mbrohen nga çrregullimet informative, dezinformatat, propaganda dhe rreziqet e tjera nga lojërat e ndryshme dhe sfidat e rreziqshme në platforma si TikTok", tha ai për Telegrafin. Sipas hulumtimit, profesori vuri në dukje se përdorimi i platformave TikTok dhe Snapchat dominon dukshëm



me 46,9 % përdorim të Snapchatit dhe rreth 30 % përdorim të TikTok-ut. "Megjithatë, shumë prej tyre, edhe pse kanë kufizime në moshë për krijimin e llogarive, prapë i hapin ato dhe

konsumojnë përmbajtje të ndryshme", shtoi ai. Veç Edukimit Medial, Ismajli thekson rekomandime të tjera për ta mbështetur rregullimin ligjor të medieve sociale, duke sugjeruar se platformat duhet ta

kërkojnë verifikimin e moshës për krijimin e llogarive. "Për më shumë siguri, duhet të vendosen masa ligjore që ta kufizojnë përdorimin e medieve sociale nga fëmijët nën moshën e caktuar". Ismajli foli edhe për largimin e verifikuesve të fakteve nga platformat e Metas, për të cilat tha se ka më shumë pasojë negative sesa përfitime, "kjo praktikë, që synon të ofrojë më shumë liri, qasje në informacion dhe mundësi për diskutim e shprehje, në fakt rrezikon të çojë në përhapjen e dezinformatave". Ismajli apelon për edukim medial si e vetmja zgjidhje afatgjatë për mënyrën e përdorimit të medieve dhe aftësimin për t'u bërë vetë verifikues të fakteve dhe për të marrë njohuri bazike që mundësojnë dallimin e informacioneve të sakta nga ato të pasakta.

## Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i dhurohet donacion për ekspertiza të ADN-së për zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 JANAR - Në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme është mbajtur të mërkurën ceremonia e dorëzimit-pranimit të pajisjeve për ekspertizë të ADN-së, pjesë e Programit: "Zgjidhja e rasteve të personave të zhdukur nga lufta në Kosovë", i cili implementohet nga ICMP, i mbështetur nga BE përmes ambasadës Suedeze - programi SIDA (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim) dhe ambasadës Italiane. Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Punëve të Brendshme,



Xhelal Sveçla, Samira Krehic, zëvendësuese e kryesuesit të Programit të ICMP-së për Ballkanin Perëndimor, Jonas Westerlund, ambasador i

Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Antonello De Riu, ambasador i Republikës së Italisë në Kosovë, Andin Hoti, kryesues i Komisionit Qeveritar

për Persona të Zhdukur, si dhe zëvendësuesi i drejtorit të AKF-së, Ilir Kukaj. Agjencia e Kosovës për Forenzikë që nga viti 2020 është duke marrë pjesë në projektin rajonal të ICMP-së, që ka për objektivi kryesor fuqizimin e kapaciteteve vendore në çështjen e testimit (analizës) të ADN-së lidhur me identifikimin e personave të zhdukur. Me këtë rast ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka vlerësuar lart angazhimin e të gjithë aktorëve në procesin e personave të pagjetur. Ai vuri në dukje se me pranimin e këtij donacioni, falë edhe angazhimit të zyrtarëve të AKF-së, do të lehtësohet procesi i zbulimit përmes ADN-së, në mënyrë që të bëhet identifikimi

i personave të zhdukur përmes mbetjeve mortore. Pajisjet e pranuar nga ICMP për ekspertiza të ADN-së janë teknologjia e fundit në këtë fushë dhe do të ndikojnë pozitivisht në ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, në fushën e hetimit kriminal dhe ekspertizës forenzike sipas standardeve ndërkombëtare ISO17025-2017. Ky projekt si objektivi kryesor e ka fuqizimin e kapaciteteve vendore në çështjen e testimit (analizës) të ADN-së lidhur me identifikimin e personave të zhdukur. Vlera totale e kontingjentit të pajisjeve është rreth 38 000.00 euro.

## Konsumatorët po kryejnë nga eKESCO 1 milion euro pagesa çdo muaj

PRISHTINË, 22 JANAR - Aplikacioni eKESCO, që ofron shërbime për konsumatorët sa i përket furnizimit me energji elektrike, po shndërrohet në aplikacion lider në Kosovë. Edhe vitin e fundit eKESCO ka shënuar rritje të madhe në të gjithë parametrat e saj. Numri i konsumatorëve që e përdorin këtë aplikacion ka arritur në mbi 298 mijë konsumatorë, një rritje për më tepër se 63 mijë në krahasim me një vit më herët. Qytetarët e Kosovës tashmë po orientohen komplet drejt botës digjitale, ndërsa KESCO po ua lehtëson atë rrugëtim. "Në eKESCO konsumatorët nuk po hyjnë vetëm për të marrë

informata, por edhe për të kryer shërbime të ndryshme. Një numër në rritje të madhe është ai i konsumatorëve që nuk ia mësyjnë më lokacioneve fizike për të paguar rrymë, por e bëjnë këtë përmes telefonit të tyre. Aty është shënuar edhe rritja më e madhe e përdorimit të eKESCO gjatë 2024. Tashmë, çdo muaj aty konsumatorët kryejnë rreth 1 milion euro pagesa duke arritur në afro 12 milionë euro në total për vitin e fundit, nga 7.25 milionë sa u kryen në vitin 2023, apo 62.7 për qind rritje", ka njoftuar KESCO, duke shtuar se kjo rritje ka qenë gjithpërfshirëse pasi ka ardhur nga rritja e numrit të transaksioneve që në vitin e

fundit ka arritur në gati 200 mijë nga 123 mijë sa ishte një vit më herët. "Kjo rritje e gjithëanshme e eKESCO është tregues i përqafimit të teknologjive moderne nga KESCO me misionin që konsumatorët të marrin shërbime sa më të shpejta, më kualitative dhe më të sigurta. Kompania do të vazhdojë të jetë në hap me kohën me secilin zhvillim teknologjik, si një nga parakushtet e zhvillimit të sektorit energjetik në veçanti dhe ekonomisë në përgjithësi", thuhet tutje në njoftimin e KESCO-s. Aplikacionin mund ta shkarkoni në IOS dhe Android.



Konsumatorët po kryejnë nga eKESCO 1 milion euro pagesa çdo muaj



## Kurti takon një grup investitorësh në Davos, i fton të investojnë në Kosovë

PRISHTINË, 22 JANAR - Në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, në Shtëpinë e Kosovës (House of Kosovo), e filloi qëndrimin e tij në Zvicër kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, gjersa takoi një grup investitorësh strategjikë. Në takim kryeministri shoqërohej nga ministrja e Ekonomisë, Artane

Rizvanolli. Takimi ishte i fokusuar në investimet në energji e ku kryeministri theksoi se Kosova po investon në vazhdimësi që të arrijmë sa më shumë pavarësi dhe siguri energjetike. Ai shtoi se Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031 është thelbësore dhe qëndron si pikë kyçe e

avancimit energjetik të vendit dhe tranzicionit të drejtë, drejt energjisë së ripërtërishme. Kryeministri Kurti e ftoi grupin e investitorëve të investojnë në Kosovë e t'i shfrytëzojnë kushtet e favorshme për investim, veçanërisht në sektorin e energjisë, që mbetet sektor kyç për zhvillimin e vendit.



## Nga 1 janari 'Pastrimi' inkason faturat e amvisërisë në Prishtinë

PRISHTINË, 22 JANAR - Qytetarët e amvisërisë në komunën e Prishtinës nga ky muaj faturat e mbeturinave do t'i pranojnë nga kompania "Pastrimi", të cilën nga viti 2018 deri më 31 dhjetor 2024 e ka bërë komuna e Prishtinës.

Drejtues të kompanisë "Pastrimi" kanë bërë me dije se kështu e parashihet rregullorja e re, ndërsa pritet që komuna e Prishtinës t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Kompania "Pastrimi" ka paralajmëruar se nga 1 janari ka filluar inkasimin e faturave për klientët e amvisërisë, të cilën deri tash e ka bërë komuna e Prishtinës.

Zëdhënësja e Kompanisë "Pastrimi", Arbnora Ademi, i tha Radio Kosovës se rregullorja e cila është ndryshuar në fund të vitit 2024, parashihet që kjo

kompani nga ky muaj ta bëjë faturimin e mbeturinave për amvisërinë. "Të gjithë klientët në komunën e Prishtinës faturat e amvisërisë nga data 1 janar të këtij viti do t'i paguajnë nga Kompania 'Pastrimi'. Në fundvit rregullorja është korigjuar nga Kuvendi Komunal dhe në bazë të kësaj rregulloreje, që aktualisht është legjitime, kjo përgjegjësi ka kaluar te kompania 'Pastrimi' dhe tani kompania jonë do ta bëjë inkasimin", tha ajo.

Në lidhje me këtë çështje, e cila ka krijuar paqartësi te qytetarët, nga komuna e Prishtinës kanë theksuar se Ndërmarrja "Pastrimi", bazuar në një vendim të miratuar nga Kuvendi Komunal në fund të vitit 2024, është përgjegjëse për faturimin e mbeturinave për qytetarët e amvisërisë nga 1 janari 2025.



Drejtori i Shërbimeve Publike në komunën e Prishtinës, Bekim Brestovci, në një përgjigjeje me shkrim për Radio Kosovën, tha se komuna ka ngritur disa shqetësime mbi procesin e miratimit të këtij vendimi dhe se komuna është në proces të përgatitjes së një ankese në Gjykatën

Kushtetuese për pezullimin e vendimit të Kuvendit Komunal. "Lidhur me çështjen e shpërndarjes së faturave nga Ndërmarrja 'Pastrimi' dhe konfuzionin e krijuar te qytetarët, ju informojmë si vijon: Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar një vendim që i jep të drejtë

Ndërmarrjes publike 'Pastrimi' për të kryer inkasimin e mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë. Deri tani, ky proces është menaxhuar nga Komuna e Prishtinës, e cila ka mbledhur mjetet dhe ka kontraktuar ndërmarrjen për kryerjen e shërbimit. Megjithatë,

komuna ka ngritur disa shqetësime të bazuara ligjërisht mbi procesin e miratimit të këtij vendimi. Lidhur me këtë, komuna ia ka adresuar një ankesë MAPL-së, mirëpo deri tani nuk kemi marrë përgjigje nga kjo ministri. Në vend të saj, kemi marrë një përgjigje nga Ministria e Ambientit, të cilën e kontestojmë për shkak të mospërputhjeve që kemi identifikuar me dispozitat ligjore dhe kushtetuese", ka theksuar ai.

## Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve krahasuar me një vit më parë



PRISHTINË, 22 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin dhjetor 2024.

Në muajin dhjetor 2024, krahasuar me muajin dhjetor 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet e Trepçës (-20,8 %); skema për pensionet invalidore (-14,9 %); skema e ndihmës sociale (-11,1 %); skema për pensionet familjare (-3,9 %); skema e

kompensimeve për personat e verbër (-2,1 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,7 %); skema e pensioneve kontributpaguese të moshës (-1,3 %).

Në muajin dhjetor 2024, krahasuar me muajin dhjetor 2023, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (14,5 %); skema e pensioneve të Forcës së

Sigurisë së Kosovë (11,9 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,1 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,9 %); skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (2,9 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (2,9 %); skema e pensioneve bazike të moshës (2,9 %); skema për veteranët e luftës (0,3 %).

## ATK-ja: Individët mund të pajisen me vërtetim tatimor edhe përmes platformës eKosova

PRISHTINË, 22 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar të gjithë individët se tani mund të pajisen me vërtetim tatimor edhe përmes platformës eKosova. "Administrata Tatimore e Kosovës ka ndërlidhur sistemin e saj me platformën eKosova,



kështu që çdo individ i cili ka nevojë që të pajiset me vërtetim tatimor, këtë mund ta bëjë qoftë përmes uebfaqes së ATK-së www.atk-ks.org, Zyrës së Shërbimit të Tatimpaguesve në ATK apo edhe përmes platformës eKosova. Ndërsa, çdo tatimpagues (biznes), me vërtetim

tatimor mund ta pajiset vetëm përmes Sistemit Elektronik EDI apo Zyrës përkatëse të Shërbimit të Tatimpaguesve në ATK. Për të gjeneruar vërtetimin tatimor përmes platformës eKosova, individit duhet të regjistrohet në platformë dhe të krijoj llogarinë e tij", ka njoftuar ATK-ja.



# Revolucione dhe kryengritje që ndryshuan Historinë



Zbuloni disa nga revolucionet që transformuan shoqërinë dhe sfiduan rendin ekzistues, nga lufta për pavarësi në Amerikë dhe lëvizja për të drejtat civile, te Pranvera Arabe dhe beteja e vazhdueshme kundër ndryshimeve klimatike. Revolucionet kanë fuqinë të riformësojnë gjithçka, nga jeta jonë e përditshme te ekonomitë lokale dhe imagjinata kolektive. Ato nuk janë aspak një koncept i ri – kanë ndodhur për shekuj me radhë. Disa tashmë kanë hyrë në historinë botërore, ndërsa të tjera vazhdojnë dhe evoluojnë.

Çdo revolucion zhvillohet në mënyrën e vet unike, por të gjitha ndajnë një fije të përbashkët dhe tejet të fuqishme: sfidojnë dhe transformojnë të kuptuarit tonë për shoqërinë dhe potencialin e saj.

Nga Revolucioni Amerikan te Pranvera Arabe, këto janë disa nga lëvizjet që kanë bërë pikërisht këtë.

## 1. Revolucioni Amerikan

Është viti 1776 dhe 13 koloni

janë në prag të rebelimit kundër Perandorisë Britanike. Ajo që filloi si protestë kundër taksave për çajin dhe letren u shndërrua shpejt në një luftë të gjerë për pavarësi. Motivimi ishte i thjeshtë: të shkëputeshin nga Britania e Madhe dhe të ndërtonin një komb mbi parimet e lirisë dhe vetëqeverisjes – vlera që Amerika i çmon edhe sot. Më 4 korrik 1776, u miratua dhe u firmos Deklarata e Pavarësisë dhe amerikanët luftuan pa u ndalur për lirinë e tyre. Sot, Dita e Pavarësisë festohet me parada, fishekzjarre dhe aktivitete festive.

## 2. Revolucioni Rus

Rusia në vitin 1917 ishte një vend i vështirë për të jetuar si fshatar ose punëtor. Carët e pasur sundonin vendin, ndërsa qytetarët e zakonshëm përballëshin me varfëri, pabarazi dhe luftë. Atëherë erdhi Lenini me premtimet e tij për “paqë, tokë dhe bukë”. Nuk është çudi që masat e lodhura i pranuan Bolshevikët me krahë hapur.

Revolucionin Rus jo vetëm që

rrëzoi një regjim të gjatë imperial, por ndihmoi në shembjen e monarkive shekullore në Evropë. Por nga ana tjetër, solli sistemin komunist në skenën globale.

## 3. Lëvizja për të Drejtat Civile

Segregimi dhe padrejtësia racore ishin realitete të përditshme për afro-amerikanët në vitet 1960. Shtetet e Bashkuara propagandoheshin si “toka e lirisë”, përveç nëse ishte person me ngjyrë. Në këtë rast, nuk mund të uleshë në të njëjtat tavolina, të përdorje të njëjtat tualete apo të shkoje në të njëjtat shkolla si njerëzit e bardhë. Madje, votimi ishte pothuajse i pamundur.

Deri kur liderë si Martin Luther King Jr. dhe aktivistë në mbarë vendin thanë “mjaft”. Përmes protestave paqësore, bojkotimeve dhe fjalimeve të fuqishme, ata drejtuan Lëvizjen për të Drejtat Civile, duke nxitur ndryshime sociale që vazhdojnë të frymëzojnë lëvizjet për drejtësi edhe sot.

## 4. Revolucionin Francez

Franca në vitin 1789 ishte një “tenxhere me presion”. E nxitur nga pabarazia dhe një monarki e shkëputur nga realiteti, më në fund gjithçka shpërtheu kur revolucionarët sulmuan Bastijën. Pasuan gjyotinat, idetë radikale dhe një slogan i ri: “Liri, barazi, vëllazëri”.

Tërmetet e Revolucionit Francez u ndjenë jo vetëm në Francë, por në mbarë Evropën, duke frymëzuar njerëzit të sfidojnë autoritetin dhe të luftojnë për ideale demokratike. Revolucionin ishte i përgjakshëm, por përfundimisht ndihmoi në ngjitjen e Napoleonit në pushtet.

## 5. Pranvera Arabe

Në vitin 2010, protesta e një burri në Tunizi ndezi një valë kryengritjesh në të gjithë botën arabe. Njerëzit e zakonshëm dolën në rrugë për të kërkuar dinjitet, liri dhe kushte më të mira jetese. Regjime që dukeshin të patundshme u shembën nën peshën e fuqisë popullore dhe,

për një moment, bota mbajti frymën.


Shpresa? Një epokë e re lirie për popujt në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Ishte frymëzuese për t'u parë. Por, si shumë revolucione, pasojat janë të ndërlikuara. Disa vende vazhdojnë të përballen me konflikte dhe të tjera luftojnë për të ekuilibruar liritë e reja me stabilitetin. Një kujtesë se rruga drejt ndryshimit është komplekse.

## 6. Revolucionin për Ndryshimet Klimatike

Ky është revolucionin që askush prej nesh nuk mund ta injorojë. Nga grevat e shkollave të Greta Thunbergut te protestat masive globale, njerëzit kudo po kërkojnë veprime ndaj ndryshimeve klimatike. Rreziku nuk mund të ishte më i madh.

Nivelet e rritura të detit, moti ekstrem dhe zhdukja e mijëra specieve janë pasojat. Është një garë kundër kohës për të ndryshuar zakonet tona dhe për të shtyrë politikën që do t'u japin gjeneratave të ardhshme një shans për të mbijetuar. / bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Shtyhet për një ditë Kuvendi i Punës i FBK-së

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 21 janar ka marrë vendim për shtyrjen e datës së

organizimit të Kuvendit të Punës dhe Statutor të FBK-së. Kuvendi, i cili ishte paraparë të mbahej më 30 janar, për arsye

teknike të organizimit, është shtyrë për 31 janar. Kuvendi do të zhvillohet në të njëjtin vend dhe orar. "Ky vendim u miratua

nga të gjithë anëtarët e Bordit të FBK-së, duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të një organizimi të suksesshëm dhe

të mirëkoordinuar të këtij aktiviteti të rëndësishëm për Federatën", thuhet në njoftimin e FBK-së.

# Fadil Bytyqi emërohet president i ri i FC Suhareka



### "Epoka e re"

Suharekë, 22 janar - FC Suhareka e ka mbajtur të mërkurën Kuvendin Zgjedhor në të cilin është zgjedhur presidenti i ri, Fadil Bytyqi. Në këtë Kuvend janë zgjedhur edhe anëtarët e tjerë të bordit: Adrian Hoxhaj (nënkryetar), Hamdi Bytyqi (anëtar), Shyqeri Hoxhaj (anëtar), Edin Berisha (anëtar), Berat Berisha (person zyrtar i klubit). Presidenti Bytyqi shprehu falënderime për besimin e dhënë dhe konfirmoi përkushtimin e tij për të punuar pa kompromis

për rritjen dhe suksesin e klubit.

Ndërsa FC Suhareka ka konsideruar se për klubin ka filluar një epokë e re: "Ky moment shënon fillimin e një epoke të re për klubin tonë, ku synojmë ta fuqizojmë ekipin, t'i avancojmë projektet për të rinjtë dhe të arrijmë suksese të reja sportive. Në emër të klubit tonë dëshirojmë të shprehim mirënjohjen më të thellë për të gjithë anëtarët e kryesisë së kaluar të FC Suhareka për përkushtimin, sakrificat dhe punën e palodhshme gjatë mandatit të tyre". "Udhëheqja juaj ka qenë një faktor kyç në

zhvillimin dhe arritjet e klubit, duke lënë një trashëgimi të çmuar për të ardhmen tonë. Faleminderit për vizionin, përkushtimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që keni ofruar për çdo lojtar, tifoz dhe projekt të klubit! Tani, me mbështetjen e të gjithëve, ne synojmë ta vazhdojmë rrugën drejt majave të reja. Ju mbeten gjithmonë pjesë e historisë dhe familjes sonë të madhe!", thuhet në postimin e FC Suhareka. Klubi nga Suhareka garon në Superligën e Kosovës në futboll, derisa sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e pestë me 25 pikë të grumbulluara.

### SHKURT

#### Shiten të gjitha biletat për ndeshjen Anglia - Shqipëria

Të gjitha biletat që ishin në dispozicion për tifozët shqiptarë në stadiumin "Wembley" për ndeshjen e parë kualifikuese Angli - Shqipëri janë shitur. Kështu ka njoftuar Federata Shqiptare e Futbollit. Në njoftimin e FShF-së thuhet se ka pasur një interes të jashtëzakonshëm nga tifozët e Kombëtares "Kuqezi" për këtë sfidë, të cilët, si gjithmonë, do të jenë në mbështetje të ekipit. Ndeshja Angli - Shqipëri, e vlefshme për kualifikueset e Kupës së Botës 2026, do të luhet më 21 mars, në orën 20:45, në stadiumin "Wembley" të Londrës.

#### Napoli dhe Lazio vazhdojnë interesimin për Ismajlin

Mbrojtësi Ardian Ismajli vazhdon të jetë opsion për Napoli dhe Lazio, skuadra që po tentojnë t'i sigurojnë shërbimet e tij gjatë këtij muaji. Ismajli që është pjesë e Empolit po pëlqehet si nga Napoli ashtu edhe Lazio pas paraqitjeve të mira që këtë sezon i ka treguar në Serinë A. 28-vjeçari është ndër mbrojtësit më të vlerësuar në kampionatin italian, ndërsa këtë sezon ka 22 paraqitje në të gjitha garat për Empolin. Ai pritet të largohet nga Empoli në këtë afat kalimtar apo në verë kur edhe i skadon kontrata pasi po dëshiron që karrierën ta vazhdojë në ndonjë skuadër më të madhe. Ismajli prej vitit 2021 është pjesë e Empolit, ndërsa karrierë në Itali ka bërë edhe te skuadra e Spezias.

#### Golden Eagle Ylli paraqet trajnerin e njohur sloven

Suharekë, 22 janar - KB Golden Eagle Ylli ka paraqitur trajnerin e ri Ales Pipan. Pipan para Yllit kishte udhëhequr klube prestigjioze si Krka, Union Olimpija, Zlatorog Lasko, Zadar, Anwil Wloclawek, MZT Skopje dhe ka shërbyer trajner i kombëtareve të Sllovenisë, Polonisë dhe Maqedonisë së Veriut. "Kemi kënaqësinë ta prezantojmë trajnerin tonë të ri, Ales Pipan, një emër i njohur në basketbollin evropian. Me një karrierë të gjatë dhe të suksesshme, Pipan ka udhëhequr klube prestigjioze si Krka, Union Olimpija, Zlatorog Lasko, Zadar, Anwil Wloclawek, MZT Skopje, dhe ka shërbyer trajner i kombëtareve të Sllovenisë, Polonisë dhe Maqedonisë së Veriut. I njohur për strategjitë e tij të shkëlqyera dhe aftësinë për të zhvilluar ekipe fitimtare, Pipan sjell me vete një përvojë të jashtëzakonshme dhe një frymë të pathyeshme fitoreje. Filozofia e tij e bazuar në disiplinë dhe bashkëpunim na jep besim të plotë se ai do të jetë udhëheqësi i duhur për ekipin tonë. Le t'i urojmë mirëseardhjen një prej mendjeve më të mëdha të basketbollit dhe të bëhemi gati për një sezon të paharrueshëm!", thuhet në njoftimin e Yllit.

## Arifi emërohet sekretar i përgjithshëm i FHK-së, Kolgeci i vetmi kandidat për kryetar

Prishtinë, 22 janar - Në mbledhjen e Bordit të Federatës së Hendbollit të Kosovës është konstatuar se Edi Kolgeci është kandidati i vetëm për president të ri të Federatës së Hendbollit të Kosovës. 20 janari ishte afati i

fundit për të bërë nominimet, ndërsa Kolgeci është i vetmi që ka plotësuar kushtet e kërkuara për të kandiduar për kryetar. Ai aktualisht është kryetar i KH Prishtina dhe anëtar i Bordit të FHK-së. Presidenti Saraçini, nën udhëheqjen e të cilit janë

arritur suksese historike për hendbollin dhe sportin e Kosovës në përgjithësi, është në fund të mandatit të tretë, sa edhe lejohen me statut të federatës. "Në mbledhjen e së martës u vendos që Muhamet Arifi të jetë sekretar i

përgjithshëm i Federatës së Hendbollit të Kosovës. Arifi deri më tani ishte ushtrues detyre i sekretarit të përgjithshëm të FHK-së, kurse performanca e tij është vlerësuar lart", thuhet në njoftimin e FHK-së.





## Flick: Hera e parë që më ndodhte një përmbysje e tillë

BARCELONË, 22 JANAR - Suksesi i çmendur i Barcelonës në "Da Luz" tërboi jo vetëm protagonistët e këtij takimi, por rrëmbeu edhe faqet e para në të përditshmet spanjolle: "Delir", shkruan "Mundo Deportivo". "Të çmendurit", ishte titulli

kryesor i "Sport"-it. Nuk kishte përjetuar kurrë një përmbysje të tillë as Hansi Flick, trajneri i Barcelonës. "Ishte një ndeshje e çmendur. Gjëja më e mirë ishte mentaliteti. Ky është futboll. Kurrë në jetën time nuk kisha përjetuar një kthim si ky. Tani

e rëndësishme është të fokusohemi te Valencia, më pas tek Atalanta. Duhet të jeni të qetë dhe të mendojmë se si do të mposhtim Atalantën", u shpreh Flick. Nuk mund të mungonte dhe një koment në lidhje me Szczesny, por Flick nuk preferoi ta drejtojë gishtin

nga portieri polak: "Ai bëri disa gabime, por si gjithë të tjerët. Unë nuk flas për situata individuale, por më pas ai bëri disa pritje të rëndësishme. Ne fitojmë së bashku dhe humbasim së bashku", ka shtuar trajneri i Barcelonës.



## Reali thyen rekord, 1 miliard euro të hyra vjetore

MADRID, 22 JANAR - Real Madridi njihet si klub rekordmen në fushën e blertë. Por, gjiganti madrilen ka thyer rekord edhe jashtë saj. Në fakt, "Los Blancos" janë bërë klubi i parë në botë që e arrin shifrën e 1 miliard eurove të ardhura vjetore. Më saktësisht, po flasim për sezonin 2023/24, ku "Football Benchmark" zbulon se "Mbretërit" i kishin 1.065 miliard euro të hyra për një vit. Natyrisht, më së shumti madrilenët kanë fituar nga marketingu dhe nga UEFA për sukseset e arritura në një sezon për mbamendje. Madrilenët i fituan 251 milionë euro nga ndeshjet e zhvilluara, respektivisht nga sukseset e tyre, si asnjë klub tjetër. Ndërkohë, 340 milionë euro iu përkasin të drejtave televizive, ndërsa vetëm Manchester City me 343 milionë, ka fituar më shumë në këtë aspekt. Kurse, aspekti komercial, përkatesisht reklamën, klubit të Florentino



Perezit ia kanë sjellë hiç më pak se 474 milionë euro. Prapa Realit, në vendin e dytë gjendet Manchester City me 838 milionë euro të hyra vjetore, kurse podiumin e mbyll Paris

Saint-Germaini me 806 milionë. "Top 10" mbyllet me Manchester Unitedin, Barcelonën, Borussia Dortmundin, Milanin, Interin, Juventusin dhe Napolin.

## LeBron i papërmbajtshëm mund Washingtonin



LOS ANXHELOS, 22 JANAR - Ekipi i Lakersave fitoi me rezultat 111-88 ndaj Washingtonit dhe qëndron në zonën "play-off" në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje pa shumë histori, dominuar nga vendasit, ku u dallua LeBron James me një "triple

double" (21 pikë, 10 rebound, 13 asistime), ndërsa Davis ishte shënuesi më i mirë me 29 pikë e 16 rebound. Pa probleme fiton edhe skuadra e Denverit, që mundi thellë me rezultat 144-109 Philadelphias. Edhe Nikola Jokiq ishte protagonist i një "triple

double" (27 pikë, 13 rebound, 10 asistime), ndeshje ku u dallua edhe kolektiviteti i skuadrës vendase (6 lojtarë realizuan mbi 10 pikë). Zhgënjën sërish Miami, që u mund me shifrat 116-107 në fushën e tij nga Portlandit (Simons 24 pikë), ndërsa New York, falë 25 pikëve e 16 rebound të Towns fitoi me rezultat 99-95 derbin me Brooklynin. Fiton edhe skuadra e Torontos, që mundi me shifrat 109-93 Orlandon, ndeshje ku u dallua Barrett me 19 pikë.

### REZULTATET

Brooklyn - New York	95-99
Miami - Portland	107-116
Toronto - Orlando	109-93
Denver - Philadelphia	144-109
Lakers - Washington	111-88

## Hamiltoni nuk humbet kohë, pas prezantimit provon makinën e Ferrarit

Pas prezantimit dy ditë më parë në Maranello si pilot i ri i Ferrarit, britaniku Lewis Hamilton ka kryer edhe provat e para me "kokëkuqen". Në pistën e Fioranos, 7 herë kampioni i

botës në Formula 1 ka pilotuar makinën SF-23 (makina e vitit 2022). Fillimisht skuadra ka pritur largimin e mjegullës para se Hamiltoni të zbrisë në pistë. Fillimisht ai bëri

vetëm një xhiro dhe u kthye në bokse, duke përshëndetur edhe mjaft tifozë të Ferrarit të pranishëm në zonën jashtë pistës. Më pas Hamiltoni u rikthye në pistë për të bërë

dhjetë xhiro duke testuar procedurat e nisjes. Xhirot e para u kryen në një asfalt të lagësht me stafin e inxhinierët që ndiqnin gjithçka me kujdes. Makina e kuqe, me numrin 44 në të,

do të dalë disa herë në pistë gjatë ditës së sotme, madje edhe gjatë pasdites. Hamiltoni paraqiti për fansat edhe kokoren e tij të re, e verdhë me logon e Ferrarit në të.

### SHKURT

#### Dortmundi shkarkon trajnerin Nuri Shahin

Borussia e Dortmundit ka shkarkuar trajnerin Nuri Shahin. Turku i lindur në Gjermani rezultoi një zhgënjim pasi mori drejtimin e skuadrës në verën e vitit 2024. Katër humbje ka aktualisht Dortmundi. Klubi që vitin e kaluar shkoi në finalen e Ligës së Kampionëve, mbrëmjen e së martës u mposht nga Bologna me rezultatin 2-1. Borussia Dortmund aktualisht ndodhet 20 pikë prapa kryesuesve të Bayernit në Bundesligë. Vetëm një fitore në nëntë ndeshjet e fundit, është mjaft pak për klubin që e nisi sezonin me pritshmëri të larta.

#### Skrinier largohet nga PSG-ja, i bashkohet Fenerbahçes

Në mënyrë të papritur, qendërmbrojtësi slovak i PSG-së, Milan Skriniar, ka zgjedhur ta vijojë gjysmën e dytë të sezonit në Stamboll, te Fenerbahçe e Jose Mourinhos. Skriniar po i bashkohet Fenerbahçes në formë huazimi nga kampionët parisienë. Fabrizio Romano njofton se mbrojtësi slovak është rrugës për në Stamboll, ku do t'i kryejë vizitat mjekësore dhe nënshkruajë kontratën, pasi marrëveshja mes të gjitha palëve është mbyllur tani.

#### Ballack: Liverpooli është favoriti kryesor për ta fituar Ligën e Kampionëve

Ish-futbollisti i Gjermanisë, Michael Ballack, ka thënë se ka qenë i befashuar pozitivisht nga fillimi mbresëlënës i Arne Slot në Liverpool dhe e cilësoi skuadrën angleze favorite për ta fituar Ligën e Kampionëve. Duke folur për mediumin gjerman "Sport Bild" pas ndeshjeve të së martës, Ballack zgjodhi Liverpoolin pretendent kryesor për ta fituar kompeticionin më të madh evropian. "Duke gjykuar nga paraqitjet e tyre deri më tani, Real Madridi nuk është favoriti im kryesor. Ky do të ishte Liverpooli, i cili aktualisht po dominon në Ligën e Kampionëve. Isha i befashuar pozitivisht nga mënyra sesi Arne Slot e menaxhoi tranzicionin pasi epoka e Jurgen Kloppit mori fund. Mendoj se është favoriti kryesor për ta fituar garën", ka thënë Ballack.

#### City përgatit një ofertë marramendëse për Raphinha

Manchester City thuhet se po përgatit një ofertë shumë të lartë për ta bindur Barcelonën që ta lirojë sulmuesin e tyre brazilian, Raphinha. Pep Guardiola është i interesuar për të bërë ndryshime të rëndësishme në skuadrën e tij për sezonin e ri dhe tashmë ka etiketuar disa objektiva. Sipas mediumit "Todofichajes", Manchester City është i interesuar për nënshkrimin e sulmuesit anësor të Barcelonës, Raphinha. Qytetarët thuhet se janë të përgatitur të ofrojnë 100 milionë euro për yllin brazilian. Raporti sugjeron se Arsenali dhe Chelsea po monitorojnë 28-vjeçarin, por një ofertë kaq e rëndësishme nga City mund t'i pengojë klubet e tjera. Ndryshe, Raphinha ka qenë në formë mbresëlënëse këtë sezon, duke shënuar 22 gola dhe duke dhënë 11 asistime në 30 ndeshje për Barcelonën.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Traktor” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811964453 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Traktor” L.L.C.Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811964453 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Traktor” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811964453 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Lentii” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810197922 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Lentii” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810197922 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Lentii” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810197922 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Trokit Vision” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811406546 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Trokit Vision” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811406546 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Trokit Vision” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811406546 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Berat Terpuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Nexhmedin Nixha”. dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Elvis Kuzhnini B.I. NGA Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810107161.
- Kristjan Margegaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha”. - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Mimoza Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”. - Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Ilmi Sadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Pjetër Bogdani”. - Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**

